



Prishtinë, 16.09.2022

PËRGJIGJE NË KOMENTET E KEDS DHE KESCO

Përmbledhje

Pas raportit fillestar *Raport i monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS) dhe furnizuesin me energji elektrike (KESCO)*, i licencuari ka pasur mundësi të paraqes komentet për një periudhë dy javore.

Gjatë periudhës 2 javore, ZRRE ka pranuar komente nga operatorët KEDS dhe KESCO, të cilat i ka analizuar me kujdes dhe ka paraqitur përmes këtij dokumenti propozimet përfundimtare lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS) dhe furnizuesin me energji elektrike (KESCO).

ZRRE ka dhënë përgjigjet në komentet e palës sipas grupimit të çështjeve të trajtuara, të ndarë në paragrafe.

Komentet e KEDS/KESCO si Përgjigje mbi raportin e monitorimit të ZRRE-së

Monitorimi i operimit të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) dhe

Monitorimi i blerjeve të energjisë së OSSh (KEDS)

Komentet e KEDS/KESCO – KEDS/KESCO ka sqaruar shturjen ligjore të kompanisë dhe ndarjen e saj në dy kompani të ndara si në aspektin operativ ashtu edhe atë ligjor, por ka theksuar se KESCO që nga privatizimi ka prokuruar energji pothuajse për të gjitha palët, por me ndryshimet ligjore në pakon e fundit, që nga prilli i vitit 2017 secili i licencuar do duhej të prokuronte energjinë për nevojat e veta.

KESCO ka sqaruar faktin se ka vazhduar edhe për një kohë të kryej këto shërbime, pra të blejë energji elektrike për humbjet në nivel të transmisionit, humbjet e shpërndarjes, si dhe organizon eksportin për tepricat e KEK-gjenerimit. Përfundimisht, KOSTT në fund të vitit 2017 ka filluar të bëjë vet prokurimin e energjisë për nevojat e veta, kurse eksporti në emër të KEK ka vazhduar deri në fund të vitit 2019, derisa blerjet e energjisë për nevojat e KEDS kanë vazhduar deri në vitin 2022. KEDS kishte shpallur tender për prokurimin e humbjeve në vitin 2020, por ishte prolonguar fillimisht për shkak të Pandemisë COVID 19 e më vonë për shkak të krizës financiare. Gjithnjë sipas KESCO, të gjitha kostot për blerjen e energjisë elektrike janë mbuluar nga të licencuarit, të cilat janë evidentuar edhe në pasqyrat e audituara financiare.



Më tutje, KEDS/KESCO kanë sqaruar se obligimet e pashlyera ndaj palëve kanë rrjedhur fillimisht si rezultat i Pandemisë COVID 19 e më vonë si rezultat i krizës energjetike, kryesisht ngritjes së çmimeve të importit, duke aluduar se të hyrat e lejuara nga ZRRE për mbulimin e importit për vitin 2021 për KESCO e sidomos për KEDS nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot reale. Sipas KEDS/KESCO, ndarja e subvencionit në dhjetor të vitit 2021 ishte adresuar vetëm për furnizuesin, përderisa nevojat aktuale ishin tek shpërndarja vërtetohet edhe një herë se gjendja më e renduar ka qenë tek OSSH-ja për shkak të nevojave për import me çmime shumë të larta.

KESCO konfirmon se me qëllim që të shmangët situatës ku do të rrezikohet siguria e furnizimit me energji elektrike, ka bërë prokurim të energjisë elektrike me qëllim të mbulimit të humbjeve dhe rithekson se nuk ka nder-subvencionim ndërmjet të licencuarave, sepse kostot janë reflektuar dhe faturuar sipas tarifave fundore të aprovuara nga Rregullatori, por problemet e krizës energjetike kanë shkaktuar mos-pagesën në kohë të këtyre detyrimeve me qëllim të mos-rrezikimit të sigurimit të furnizimit me energji elektrike.

Poashtu, KEDS/KESCO ritheksojnë se kanë vazhduar t'i paguajnë detyrimet e tyre ndaj të licencuarve të tjerë varësisht nga të hyrat e arkëtuara dhe pas pagesës së obligimeve të detyrueshme.

Përgjigje e ZRRE-së

Monitorimi i operimit të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) – të gjeturat dhe konstatimet e ZRRE-së

Sa i përket pjesës së shturjes operative dhe ligjore, si dhe vazhdimin e prokurimit të energjisë për palët edhe për një kohë, ZRRE pajtohet me komentimin e palës, përfshirë këtu edhe problemet financiare me shfaqjen e pandemisë COVID 19 e më vonë krizës energjetike, por konteston mënyrën e kryerjes së shërbimit për prokurimin e humbjeve për KEDS duke shfrytëzuar llogarinë e konsumatorëve të rregulluar që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.

Prandaj ZRRE ende qëndron në konstatimin se ka ndër-subvencionim/ndër-financim të llogarisë së konsumatorëve të parregulluar nga llogaria e konsumatorëve të rregulluar që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal, e që është në kundërshtim me Nenin 5/3 të Licencës për Furnizim me Energji Elektrike lëshuar KESCO, si dhe ka rrezikuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e FSHU-së dhënë me Vendimet për Vendosjen e Obligimit të Shërbimit Publik si Furnizues me Shërbim Universal ngarkuar KESCO-n.

Financimi i llogarisë së konsumatorëve të parregulluar nga llogaria e konsumatorëve të rregulluar që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal, e që është në kundërshtim me Nenin 5/3 të Licencës për Furnizim me Energji Elektrike lëshuar KESCO, ka rrezikuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e FSHU-së dhënë me Vendimet për Vendosjen e Obligimit të Shërbimit Publik si Furnizues me Shërbim Universal ngarkuar KESCO-n.



Monitorimi i blerjeve të energjisë së OSSh (KEDS)– të gjeturat dhe konstatimet e ZRRE-së

ZRRE konsideron se nuk janë relevante sqarimet e dhëna nga KEDS lidhur me pretendimet e ZRRE-së për prokurimin e energjisë elektrike të shprehura në raportin e monitorimit, prandaj rikujton KEDS-in se nuk ka prokuruar energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve siç parashihet me dispozita ligjore, respektivisht Paragrafin 1.21 të nenit 28 të Ligji Nr 05/L-085 për Energjinë Elektrike si dhe nenit 9 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë.

ZRRE rithekson se gjatë periudhës së monitorimit, OSSh nuk ka ushtruar përgjegjësitë të dhëna me këtë legjislacion i cili obligon OSSh-në të siguroj energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jo diskriminimit.

Blerjet e Energjisë për konsumatorët e parregulluar

Komentet e KESCO- KESCO thekson se furnizimi me energji elektrike për konsumatorët e parregulluar nga KESCO ka qenë e pashmangshme duke qenë se KESCO ka qenë furnizuesi i vetëm aktiv në treg, dhe ka vazhduar furnizimin deri në pikën kur nuk është rrezikuar siguria e furnizimit, duke pasur parasysh se këta furnizohen me tarifa të parregulluara kryesisht nga importi.

Përgjigje e ZRRE-së

ZRRE konsideron se nuk janë relevante sqarimet e dhëna nga KESCO lidhur me blerjet e energjisë për konsumatorët e parregulluar, prandaj rikujton KESCO-n se blerjet për furnizim me energji elektrike për konsumatorët e parregulluar nga pagesat e mbledhura nga konsumatorët me shërbim universal përben ndër-subvencionim/ndër-financim të llogarisë së konsumatorëve të parregulluar nga llogaria e konsumatorëve të rregulluar, dhe konsiderohet shkelje të Nenit 31 të Ligjit për Energji Elektrike.

Për më tepër ZRRE rithekson se KESCO ka shkelur edhe obligimet ligjore të Nenit 37 par. 5 lidhur me Nenin 5 të Ligjit për Energjinë Elektrike, që ka të bëjë me obligimin e shërbimit publik të dhënë me vendimin e ZRRE-së, ku ndër tjera theksohet se:

5. Rregullatori siguron që kategoritë e ndryshme të konsumatorëve të mos përfitojnë nga i njëjti trajtim dhe mbrojtje, si dhe që rregullimi i çmimit të konsumatorit fundorë me të drejta të furnizimit si shërbim universal të jetë në dispozicion vetëm për të siguruar ofrimin e shërbimit universal për konsumatorë familjar dhe ata jofamiljar që gëzojnë këtë të drejtë.

Devijimet në Nominimin e Energjisë së KESCO për FSHU dhe KEDS për humbje

Komentet e KESCO- KESCO, në përgjigjen e tij ka paraqitur në forme tabelare parashikimet dhe nominimet nga viti 2018 deri 2022, duke theksuar se nuk ka dallime të mëdha. Poashtu ka sqaruar problemet që kanë rrjedhur me alokimin e kapaciteteve ndërkufitare, si dhe ka paraqitur ndikimin negativ të shkaktuar nga mos reflektimit të çmimeve të importit në tarifatat fundore, të cilat deri në



shtator të vitit 2021 para shqyrtimit të rregullt tarifor ishin të lejuara në vlerën 57 €/MWh, ndërsa në shqyrtimin e rregullt në tetor u lejuan në vlerën 90 €/MWh, e që ishin dukshëm më të ulëta se çmimet në kohë të caktuara. E tërë kjo bëri që KESCO me dt. 20 dhjetor 2021 të dërgoj shkresë zyrtare tek Rregullatori, Ministria, KOSTT, KEK dhe Kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri duke i njoftuar se për shkak të kushteve të krijuara, mund të mbështetet vetëm në prodhimin vendor, respektivisht nuk do të mbahen përgjegjëse për çfarëdo jo-balance të shkaktuar në sistemin elektro-energetik si rezultat i situatës së jashtëzakonshme.

Përgjigje e ZRRE-së

ZRRE konsideron se devijimet e shkaktuara në dhjetor 2021 në ditët specifike sillesh nga 14% deri 42% për KESCO kurse për KEDS sillesh nga -33% deri 75% e në një ditë specifike ishte 99%. Pra KESCO dhe KEDS kanë nominuar vetëm sasinë e energjisë që kishte KEK në dispozicion dhe nuk kanë tentuar të importojnë energji për këtë periudhë. Për më tepër, KESCO dhe KEDS nuk kishin ndonjë konfirmim nga ZRRE lidhur me kërkesën e tyre për mbështetje vetëm në prodhimin vendor, si dhe për mospërgjegjësi për devijimet e shkaktuara, prandaj ZRRE konfirmon nuk janë relevante sqarimet e dhëna dhe se KESCO nuk ka vepruar sipas Nenit 11.1.9 të Rregullave të Tregut, Nenit 2.5.1.2 të kodit të balancit, e poashtu KEDS, nuk ka vepruar sipas Nenit 28 paragrafit 1.3 dhe 1.17 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nenit 11.1.9 të Rregullave të Tregut, Nenit 2.5.1.2 të Kodit të Balancit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes lëshuar nga ZRRE

Bazuar në konstatimet e cekura më lartë, I PROPOZIJMË Bordit të ZRRE-së, që pas vlerësimit dhe analizimit të materialit të bashkangjitur, të konstatoj se ka bazë të mjaftueshme për aplikim e dispozitave ndëshkimore të përcaktuara me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e Rregullit për Masat Administrative dhe Gjobat.

Kjo duhet të bëhet pas që ti jepet mundësia e fundit KESCO dhe KEDS, ku ZRRE duhet të lëshoj NJOFTIM me shkrim me të cilin njofton palët se mund të përgjigjen me shkrim për shkeljet e gjetura brenda katërmëdhjetë (14) ditësh pas dërgimit të njoftimit.